



Prishtinë, 10.07.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3289_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2974_06_25** i datës 10.06.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 18.06.2026.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **L. R.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me nr. ZRRE/DMK_V_2974_06_26 i datës 10.06.2026.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me datë 10.06.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2976_06_26 me të cilin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e konsumatorit L. R., me shifër DPR - 90086736, ashtu që, e ka obliguar KESCO-n që t'i anulojë konsumatorin korrigjimin plotësues financiar të dt. 03.06.2025, dhe ka vendosur konsumatori për periudhën 11/2023 – 03/2025 të korrigjohet në vlerë financiare prej 2,530.38 €.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRe-së, për këto shkaqe:

- Deri në muajin 11/2023 e deri më 03/2025, shtëpia ime ka qenë e pa izoluar dhe për këtë arsye kam paguar shuma të larta të faturave, ndërkaq, pas izolimit të shtëpisë, janë zvogëluar faturat e rrymës;
- Kërkojë rishqyrtimin e faturimit për këtë periudhë kohore, si dhe vendimin e shkallës së parë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 18.06.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 10.06.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 13.10.2025, Përgjigjen e KESCO-s, Transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit dhe Rrjedhën e energjisë elektrike, Procesverbalin mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik me nr. 4706428 i dt. 13.03.2025, Listën e pranim – dorëzimit të njehsorit elektrik me nr. 08195075 nga Qendra e Kalibrimit si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bordi e ka analizuar procesverbalin për ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 4706428 date 13.03.2025 me të cilin vërtetohet se ekipet e KEDS kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 08195075 me gjendje të shpenzimeve TL=98969 kWh dhe TU=73716 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin nr. 86140252 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar në procesverbal vërejtjen se: “I nderuari konsumator njehsori i juaj është ndërruar. Njehsori i demontuar do të verifikohet dhe/ose të testohet në laboratorin e KEDS dhe fatura e mëparshme do të llogaritet në bazë të rezultateve”, se tek konsumatori behet korrigjimi i numrit të njehsorit sipas listës së investitorit. Bazuar në të gjeturat e ekipit të KEDS-it vërtetohet se shpenzimet e evidentuara në procesverbal përputhën plotësisht me faturimin e konsumatorit në CCP për periudhën shkurt 2025.

Po ashtu, është analizuar rrjedha e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstatohet se konsumatori ka lexime të rregullta mujore, dhe se në asnjë periudhë nuk është evidentuar se ka çrregullime në matje. Sipas listave të leximit vërtetohet se në të gjitha periudhat e leximit konsumatori ka lexime në mënyrë manuale dhe me sondë dhe po ashtu vërtetohet se konsumatori nga periudha 11/2023 deri në periudhën 03/2025 ka faturime vetëm në tarifën e ulët duke mos u faturuar në dy tarifatat, përkatësisht në tarifën e lartë.

Bordi e ka shqyrtuar listën e pranim-dorëzimit të njehsorit elektrik nr. 08195075 nga qendra e kalibrimit si dhe procesverbalin për ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 4706428 date 13.03.2025 dhe konstaton se ekipet e KEDS me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik nuk kanë vepruar konform procedurave në fuqi duke mos përcaktuar saktë gjendjen e shpenzimeve të konsumatorit me rastin e ndërrimit të njehsorit. Sipas listës së dorëzimit të njehsorit elektrik vërtetohet se gjendja e njehsorit nr. 08195075 ka qenë TL=22216 kWh dhe TU=74108 kWh kurse në procesverbalin e ndërrimit TL=98969 kWh dhe TU=73716 kWh me çka edhe vërtetohet se kjo gjendje nuk përputhët me gjendjen e shpenzimeve me rastin e ndërrimit të njehsorit. Bordi po ashtu konstaton se sipas rrjedhës së energjisë elektrike dhe listave të leximit konsumatori nuk ka pasur lexim dhe faturim të saktë nga periudha 11/2023 në tarifën e lartë pasi që gjendja e TL nuk ka ndryshuar nga periudha 10/2023 ku gjendja e lexuar dhe faturuar në CCP ka qenë TL= 98969 kWh.

Bazuar në shqyrtimin e faturave kontestuese 11/2023 deri me rastin e ndërrimit, rrjedhës së energjisë elektrike, listave të leximit, vihet re se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit për shpenzimet e periudhës kontestuese nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifatat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e*



aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

Bordi e ka shqyrtuar Korrigjimin plotësues financiar nr. 107771DPR-90086736 të datës 03.06.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej 2,656.08€, në të cilin është evidentuar si vijon: "Faturimi i kWh, për periodën 11/2023 deri 03/2025 duke u bazuar në Listën e njehsorëve Pranim/Dorëzimit nga QK, njehsori me nr.01895075 A1=22216 dhe A2=74108, dhe ka gjetur se, ky korrigjim nuk është i saktë pasi që korrigjimi duhet të jetë në vlerë 2,530.38€ si dhe që KESCO nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. *"Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese"*, andaj konsumatorit duhet t'i ofroj kontratë pagesë 17 mujore.

Rrjedhimisht, konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të cilën e shfrytëzojnë dhe kjo duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me energji elektrike, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: "Konsumatorët e kanë për obligim që paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja".

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmimeve dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuara nga KESCO si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji si dhe Rregullën për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit L. R.,
- Arkivit të ZRrE-së